



BULETIN MUJOR

QERSHOR 2025



PËRMBAJTJA

- AKSK zhvillon konsultime publike për kuadrin e ri ligjor në fushën e sigurisë kibernetike
- Siguria kibernetike, një prioritet i përbashkët BE–Shqipëri
- Cyber Balkans: Një qasje rajonale për sigurinë kibernetike
- Higjiena Kibernetike në fokus/ AKSK trajnim ndërgjegjësues në Elbasan
- Forcimi i kapaciteteve vendore për sigurinë kibernetike – Trajnim me SimSpace në AKSK
- Sulmi në Bashkinë Tiranë – AKSK menaxhon me sukses trajtimin e situatës dhe rivendosjen e sigurisë

AKSK zhvillon konsultime publike për kuadrin e ri ligjor në fushën e sigurisë kibernetike



Gjatë muajit qershor, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike organizoi një sërë takimesh konsultuese me aktorë kyç të sektorit publik dhe privat, në funksion të tre projektligjeve të rëndësishme:

"Për sigurinë e informacionit të klasifikuar të përpunuar në sisteme digjitale", "Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe portofolin e identitetit digjital" dhe "Për masat teknike dhe organizative për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit."

Qëllimi ishte mbledhja e komenteve dhe sugjerimeve për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe për ta përafuar me standardet më të avancuara të BE-së në fushën e sigurisë dhe identitetit digjital.

Siguria kibernetike, një prioritet i përbashkët BE–Shqipëri

Në kuadër të përmbylljes së projektit "Cyber Security Rapid Response", Ambasadori i BE-së në Shqipëri, z. Silvio Gonzato, zhvilloi një vizitë zyrtare në AKSK.

Projekti i financuar nga BE dhe zbatuar nga "e-Governance Academy" ka ndihmuar në forcimin e kapaciteteve të institucioneve dhe përfshirjen e mbi 2000 studentëve në fushën e sigurisë kibernetike.

Ambasadori vlerësoi rolin e Shqipërisë si partnere në rritjen e qëndrueshmërisë digjitale në rajon, ndërsa u theksua rëndësia e vazhdimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në këtë fushë strategjike.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë




www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039



Cyber Balkans: Një qasje rajonale për sigurinë kibernetike

Në kuadër të projektit “Cyber Balkans”, të financuar nga Bashkimi Evropian, AKSK mirëpriti në Tiranë përfaqësues të ekipeve CIRT nga Ballkani Perëndimor për një vizitë studimore dhe trajnim praktik në Cyber Lab dhe Cyber Range.

Aktiviteti dyditor kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve teknike për reagimin ndaj incidenteve kibernetike, përmes simulimeve realiste dhe shkëmbimit të përvojave.

Drejtori i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e ndërtimit të një mjedisi të qëndrueshëm bashkëpunimi rajonal, ku ekspertiza dhe kapacitetet të zhvillohen në mënyrë të integruar, nga arsimi bazë deri te strukturat operative.

Higjiena Kibernetike në fokus/ AKSK trajnim ndërgjegjësues në Elbasan

Në Elbasan u zhvillua një tjetër sesion ndërgjegjësues mbi Higjienën Kibernetike, pjesë e nismave të AKSK për edukimin dhe fuqizimin e qytetarëve dhe punonjësve të administratës publike në fushën e sigurisë digjitale.

Me mbi 400 pjesëmarrës online dhe fizikisht, aktiviteti solli në fokus rëndësinë e praktikave të thjeshta, por të domosdoshme për mbrojtjen nga rreziqet në mjedisin online.

Përmes shembujve konkretë dhe ndërveprimit të drejtpërdrejtë, pjesëmarrësit u njohën me mënyrat se si të përdorin teknologjinë në mënyrë të vetëdijshme dhe të ndërtojnë zakone të sigurt në përditshmëri.



Forcimi i kapaciteteve vendore për sigurinë kibernetike – Trajnim me SimSpace në AKSK

Forcimi i kapaciteteve teknike në nivel vendor është thelbësor për një reagim të shpejtë dhe të koordinuar ndaj incidenteve kibernetike. Në ambientet e AKSK, u zhvillua një trajnim intensiv me platformën SimSpace për stafet IT dhe të sigurisë kibernetike nga bashkitë Kamëz, Elbasan, Shkodër dhe Krujë.

Pjesëmarrësit u përfshinë në simulime realiste të sulmeve, duke praktikuar zbulimin, reagimin dhe menaxhimin e incidenteve me mjetet më të avancuara.

Ky format trajnimi synon të ndërtojë një rrjet ekspertësh vendorë në mbarë territorin, duke rritur rezistencën kibernetike të institucioneve publike në çdo nivel.

Sulmi në Bashkinë Tiranë – AKSK menaxhon me sukses trajtimin e situatës dhe rivendosjen e sigurisë

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka qenë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për adresimin e incidentit kibernetik që preku sistemet e Bashkisë Tiranë, në bashkëpunim me institucionin dhe autoritetet përkatëse.

Mbështetja ka përfshirë ekspertizë teknike dhe asistencë metodologjike për analizën e sulmit, rivendosjen e funksionaliteteve dhe garantimin e sigurisë së mëtejshme të infrastrukturës digjitale.

